Pas njohjes fillestare, huat e marra dhe të dhëna afatshkurtër janë matur me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar dhe me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv kur marrëveshja përbën transaksion financiar.

Përfitimet e punonjësve

Detyrimet për përfitimet e punonjësve kanë të bëjnë me pagesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të kontraktuara. Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. *Kontributet e shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shoqëria nuk operon me ndonjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas pensioni.*

3.3. Aktivet jo - financiare

Aktivët jo-financiare fillimisht janë njohur me kosto historike më pas janë matur mbi baza të tjera të matjes:

- a) **Inventarët**, me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të shitjes minus koston për të përfunduar shitjen;
- b) **Aktivët afatgjatë materiale**, me koston e amortizuar (ose vlerën e drejtë si një alternativë e lejuar në SKK 5)
- c) **Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me aktivët jo-financiare** që janë në përdorim ose mbahen për shitje;

3.3.1. Inventari

Inventarët, në njohjen fillestare janë matur me kosto dhe pas njohjes me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur. Për vlerësimin e inventarit shoqëria ka përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Kostoja e inventarit përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, koston e prodhimit ose shndërrimit dhe koston të tjera të nevojshme për sjelljen e tyre në vendndodhjen dhe kushtet aktuale.

3.3.2. Aktive afatgjatë materiale (AAM)

AAM të qëndrueshme në pronësi të shoqërisë, janë vendosur si kolateral kundrejt bankave që janë huadhënëse deri në shlyerjen e plotë të tyre. Bazuar në vlerësimin tonë nuk rrezikohet konfiskimi apo sekuestrimi i tyre.

Njohja. Shoqëria ka njohur koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv vetëm nëse:

- (a) Aktivit kontrollohet nga shoqëria;
- (b) Është e mundur që nga përdorimi i aktivit do të hyjnë përfitime të ardhshme ekonomike;
- (c) Kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Regjistrimi fillestar i AAM-së është bërë në momentin e përfutimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Pjesët e këmbimit, instrumentet dhe veglat e punës janë mbajtur si inventar dhe ngarkohen në shpenzime kur ato konsumohen. Pjesët kryesore të këmbimit dhe pajisjet rezervë janë klasifikuar aktive afatgjatë materiale kur pret për t'i përdorur ato gjatë më shumë se një periudhe. Edhe pjesët e këmbimit, instrumentet dhe veglat e punës që mund të përdoren vetëm në lidhje me një zë të aktiveve afatgjatë materiale, janë konsideruar aktive afatgjatë materiale. Toka dhe ndërtesat janë trajtuar si aktive të ndara veç e veç edhe kur ato janë blerë së bashku.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Zbatimi i politikave kontabël (vazhdon)

Matja fillestare. Aktivet afatgjata materiale, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, është matur me kosto, ku përfshihet:

- (a) Kosto e blerjes *(përfshirë taksat e importit dhe taksa të tjera të parimbursueshme, zbritur skontot tregtare dhe rabatat)*
- (b) Kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të njësisë *(përfshirë koston e prodhimit të aktivit, nëse ka të tilla kosto, kostot e përgatitjes së terrenit, lëvrimin fillestar dhe trajtimin, instalimin dhe montimin, si dhe testimin e tij).*
- (c) Kostoja fillestare e vlerësuar e çmontimeve të ardhshme të një aktivi dhe të kthimit të terrenit në të cilin ai ndodhet, në gjendjen fillestare *(nëse vlerësimi i tyre përputhet me politikën për krijimin e një provizionit, siç përshkruhet në SKK 6).*

Nëse aktivi përfitohet në këmbim të një aktivi tjetër jomonetar, ose grup aktivesh, ose të një kombinimi aktivesh monetare me aktive jomonetare kostoja e aktivit të marrë është vlera kontabël e aktivit të dhënë

Kostot e huamarrjes nuk janë përfshirë në kosto, por si shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer.

Vlerësimi i mëpasshëm

Vlerësimi i mëpasshëm është bërë me modelin e kostos, i zbatuar për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së është paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Modeli i rivlerësimit nuk është përdorur nga shoqëria.

3.3.3. Vlera e amortizueshme dhe amortizimi

Vlera e amortizueshme

Në përcaktimin e jetës së dobishme të një aktivi janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- (a) Përdorimin e pritshëm të aktivit. *Përdorimi vlerësohet duke iu referuar kapaciteteve të pritshme të aktivit ose prodhimit të pritshëm.*
- (b) Konsumimin fizik të pritshëm, që varet nga faktorë të shfrytëzimit.
- (c) Vjetërimin teknik ose tregtar, që rrjedh nga ndryshimet ose përmirësimet në prodhim, ose nga një ndryshim në kërkesat për produktin apo shërbimin e siguruar nga aktivi.
- (d) Kufizimet ligjore apo të ngjashme për përdorimin e aktiveve, siç janë datat e skadimit të kontratave të qirasë.

Amortizimi

Amortizimi është llogaritur vetëm për AAM në përdorim i bazuar në vlerën neto të periudhës përkatëse. Normat ekonomike të amortizimit janë të njëjta me normave fiskale. Toka nuk është amortizuar.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Zbatimi i politikave kontabël (vazhdon)

Normat e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë :

Aktivi	2024	2023
Ndërtesa - mbi vlerën kontabël	5%	5%
Makineri e pajisje- mbi vlerën kontabël	10%	10%
Linjat e prodhimit	10%	10%
Mjete transporti - mbi vlerën kontabël	10%	10%
Mobilje dhe orendi - mbi vlerën kontabël	10%	10%
Pajisje informatike - mbi vlerën kontabël	10%	10%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.3.4. Aktive të qëndrueshme jomateriale

Aktivitet e qëndrueshme jomateriale maten me kosto

Paraqitja në pasqyrat financiare bëhet me vlerën neto (*duke zbritur nga kosto, amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi*). Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivitet. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë zbritëse përgjate jetës së aktivitet.

3.4. Provizionet

Për vitin ushtrimor, shoqëria nuk ka krijuar provizione.

Njohja e provizioneve

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij.

Fushat specifike që kërkohet krijimi i provizionit

Provizionet e garancisë - Në rast se shoqëria jep garanci për produktet që ajo shet, njihet një provizion i barabartë me shumën e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të garancisë për produktet e shitura deri në datën e raportimit.

Provizionet që lidhen me çështjet gjyqësore - Shoqëria njihet një provizion në pasqyrat financiare të saj, në lidhje me të gjitha çështjet gjyqësore ekzistuese dhe ato të mundshme, në rastet kur:

- Një ngjarje detyruese, që ka krijuar çështjen gjyqësore, ka ndodhur para datës së raportimit;
- Është e mundshme që njësitë ekonomike të përballojë shpenzime, në lidhje me zgjidhjen e çështjes gjyqësore;
- Shuma e shpenzimeve të pritshme, që lidhen me çështjen gjyqësore, mund të vlerësohet relativisht me saktësi.

Provizionet që lidhen me kontratat me kushte rënduese - Kontrata me kushte rënduese është një kontratë, në të cilën kostoja e shlyerjes së një detyrimi i kapërcen përfitimet ekonomike që priten prej kësaj kontrate.

Një provizion për kontratat me kushte rënduese do të kontabilizohet me shumën më të vogël midis humbjes që lidhet me përmbushjen e kontratës.

Provizionet për detyrimet mjedisore - Në pasqyrat financiare të saj, një njësi ekonomike do të krijojë një provizion për detyrimet mjedisore që kanë lindur para datës së raportimit nëse:

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Zbatimi i politikave kontabël (vazhdon)

- a. Sipas legjislacionit, kërkohet likuidimi ose kompensimi për një dëm specifik;
- b. Njësia ekonomike ka treguar, nëpërmjet veprimtarive dhe politikave të saj mjedisore, se ajo synon ta likujdojë vullnetarisht dëmin mjedisor.

Për detyrimin mjedisor do të njihet një provizion i barabartë me shumën e kostove që lidhen me likuidimin e dëmit.

Provizionet për kostot e ristrukturimit - Një provizion ristrukturimi do të përmbajë vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta që ndodhin vetëm njëherë:

- a. Shpenzimet që lidhen me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës;
- b. Shpenzimet që lidhen me mbylljen e një njësie prodhimi;
- c. Shpenzimet që lidhen me kontratat që janë shndërruar në kontrata me kushte rënduese, si rezultat i ristrukturimit (për shembull, marrëveshjet e qirasë financiare që kthehen në kontrata me kushte rënduese pas ristrukturimit).

3.5. Njohja e të ardhurave

Shitja e mallrave. Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë rrjedhës normale të biznesit maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke zbritur kthimet e mundshme të mallrave, zbritjet tregtare dhe rabatet. Të ardhurat njihen atëherë kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme janë transferuar tek blerësi, marrja e shërbimit është e sigurtë, kostot përkatëse si dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të shitësit në menaxhimin e mallrave, si dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri.

Shitja e shërbimeve. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit.

Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.6. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Për vitin ushtrimor shoqëria nuk ka njohur tatimin të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Gjatë vitit ushtrimor tatimi mbi fitimin paguhet paradhënie sipas detyrimit të planifikuar nga organet tatimore bazuar në legjislacionin shqiptar. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 është 15% (2023:15%). Deklaratat tatimore përfundimtare e tatimit mbi fitimin e vitit të mbyllur dorëzohen deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qellime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

3.7. Deklarimi i dividendëve pas përfundimit të periudhës raportuese

Për vitin ushtrimor shoqëria nuk ka deklaruar dividend.

Nëse një njësi ekonomike u deklaron dividendët mbajtësve të instrumentave të kapitalit neto të saj pas përfundimit të periudhës raportuese, njësi ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si një detyrim në fund të periudhës raportuese. Shuma e dividendit mund të paraqitet si një komponent i ndarë nga fitimet e pashpërndara në fund të periudhës raportuese.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Zbatimi i politikave kontabël (vazhdon)

3.7.1. Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit

Të ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare që njihen në pasqyrën e performancës, janë krijuar nga interesat dhe fitimet/ (humbjet) nga këmbimi.

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi dhe fitime nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Fitim/(humbja) nga ndryshimi i kursit të këmbimit që krijohet gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, janë njohur si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur kanë lindur. Kur një transaksion shlyhet në një periudhë kontabël të mëpasshme, diferenca e këmbimit, e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës nga periudhat kontabël.

Transaksionet në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit.

Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit (*kursi i publikuar nga BSH*). Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi janë njohur në fitim ose humbje.

Kurset kryesore të këmbimit LEK/valute janë:

Monedha	31.12.2024	31.12.2023
USD	94.26	93.94
EUR	98.15	103.88

3.8. Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare individuale

3.8.1. Kuptueshmëria

Informacioni në pasqyrat financiare është paraqitur në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit për t'i kuptuar ato. Pasqyrave financiare janë të qarta e të kuptueshme edhe për përdorues të jashtëm, të cilët mund të mos jenë në dijeni të aktivitetëve të përditshme të njësisë ekonomike.

3.8.2. Rëndësia dhe materialiteti

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të materialitetit dhe bazuar në supozimet bazë, parimet dhe karakteristikat e informacionit kontabël. Në përcaktimin e materialitetit janë marrë parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit.

Pasqyrat financiare paraqesin të gjithë informacionin material që ndikon në pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të njësisë ekonomike, mungesa ose pasaktësia në paraqitjen e tij do të ndikonte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.

Nuk ka deklaramë të gabuara të zërave, që madhësia ose natyra e tyre, ose një kombinim i të dyjave mund të jenë faktori përcaktues i materialitetit. Shoqëria ka paraqitur veçmas secilën klasë materiale të zërave të ngjashëm.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Zbatimi i politikave kontabël (vazhdon)

3.8.Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare individuale (vazhdon)

3.8.3. Besueshmëria

Informacioni i dhënë në pasqyrat financiare është i besueshëm dhe i lirë nga gabimet materiale dhe paragjykimet dhe përfaqëson me besnikëri atë që ai ka për qëllim të përfaqësojë ose që në mënyrë të arsyeshme pritet të përfaqësojë.

3.8.4. Parimi i paraqitjes me besnikëri - paraqitje e vërtetë dhe e drejtë

Transaksionet dhe ngjarjet e tjera që rezultojnë në krijimin e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit për njësinë ekonomike në datën e raportimit dhe që plotësojnë kriteret e njohjes, janë paraqitur me besnikëri.

Efektet e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera janë regjistruar besueshëm në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes së aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të përcaktuara në SKK 1.

3.8.5. Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore

Për regjistrimin e transaksioneve ekonomike në pasqyrat financiare është marrë në konsideratë përmbajtja e tyre ekonomike, e cila nuk është e thënë që të përputhet gjithmonë me formën e tyre ligjore.

Për faktin se nuk ndodh gjithmonë që përmbajtja ekonomike e transaksioneve të biznesit të përputhet me formën e tyre ligjore, për regjistrimin e transaksioneve të biznesit është mbajtur parasysh jo vetëm baza ligjore, mbi të cilën ato janë formuluar ose krijuar, por edhe përmbajtja e tyre ekonomike, e cila është e një rëndësie maksimale.

3.8.6. Parimi i paanshmërisë

Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare, është i paanshëm, dhe i painfluencuar.

3.8.7. Parimi i maturisë - Kujdesit

Përgatitja e pasqyrave financiare është bërë duke zbatuar parimin e kujdesit, pra përfshirja e një shkalle maturie në ushtrimin e gjykimeve të nevojshme në bërjen e vlerësimeve të kërkuara sipas kushteve të pasigurisë, të tilla që aktivet ose të ardhurat të mos mbivlerësohen dhe detyrimet ose shpenzimet të mos nënvlerësohen. Nuk është lejuar nënvlerësimi i qëllimshëm i aktiveve ose i të ardhurave, ose mbivlerësimi i qëllimshëm i detyrimeve ose shpenzimeve.

3.8.8. Parimi i plotësisë

Pasqyrat financiare japin të gjithë informacionin e nevojshëm për të paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të mjeteve monetare të njësisë ekonomike.

3.8.9. Qëndrueshmëria dhe krahasueshmëria

Për përgatitjen e pasqyrave financiare janë përdorur vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formata të pasqyrave financiare. Informacioni krahasues për periudhën paraardhëse është dhënë për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare, si dhe për informacionin përshkrues (*narrativ*), për të ndihmuar në kuptueshmërinë e pasqyrave financiare të periudhës kontabël aktuale.

3.9. Përzgjedhja dhe ndryshimi i politikave kontabël

3.9.1. Përzgjedhja e politikave kontabël

Për vitin ushtrimor shoqëria nuk i ka ndryshuar politikat kontabël, pra janë zbatuar në vijimësi parimet specifike, bazat, konvencionet, rregullat dhe praktikat e njësisë ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare individuale.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

3. Zbatimi i politikave kontabël (vazhdon)

Përdorimi i politikave të papërshtatshme të kontabilitetit nuk korrigjohet as nëpërmjet përshkrimit në pasqyrat financiare të politikave kontabël të përdorura, dhe as nga sqarimet e dhëna në shënimet shpjeguese.

3.9.2. Ndryshimi në politikat kontabël

Nuk ka pasur ndryshim të politikave kontabël

Politika kontabël mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme :

- a) *Kërkohej nga një SKK i ri ose i përmirësuar, ose nga Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ;*
- b) *Mundëson një paraqitje më objektive të gjendjes financiare dhe performancës financiare të njësisë ekonomike.*

Ndryshimi në politikat kontabël do të zbatohet në retrospektivë, d.m.th., sikur politika e re të ishte zbatuar gjithnjë, duke u kthyer prapa deri në fillimin e periudhës më të hershme të paraqitur.

3.10. Vlerësimet kontabël dhe ndryshimi i tyre

3.10.1. Zbatimi i vlerësimeve kontabël

Shoqëria nuk ka bërë vlerësime kontabël, pasi nuk janë evidentuar të dhëna që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Kategori vlerësimesh kontabël janë :

- c) *Vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve ;*
- d) *Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit ;*
- e) *Krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.*

3.10.2. Ndryshimet në vlerësimet kontabël

Nuk ka lind nevoja për ndryshime në vlerësime kontabël

Një ndryshim në vlerësimin kontabël është një rregullim i vlerës kontabël neto të një aktivi ose detyrimi, ose shumës së konsumit periodik të një aktivi, që rezulton nga vlerësimi i gjendjes aktuale, dhe përfitimeve të pritshme të ardhshme dhe detyrimeve lidhur me aktivin dhe detyrimin.

Ndryshimet në vlerësimet kontabël do të njihen gjatë periudhës kontabël kur ato kanë ndodhur, dhe jo në retrospektivë.

4. Korigjimi i gabimeve

Për vitin ushtrimor raportues, shoqëria nuk ka korrigjim gabimesh materiale për mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare nga vitet e kaluara.

Gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.

Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme, korrigjohen sipas njërës prej dy mënyrave të mëposhtme:

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

4. Korigjimi i gabimeve (vazhdon)

- a) *Në retrospektivë, që do të thotë se shumat e korigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke rregulluar tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara. Informacioni krahasues duhet të riparaqitet, nëse është praktikisht e mundur; ose*
- b) *Duke riparaqitur tepricat e çeljeve për aktivet, detyrimet dhe kapitalin e periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur, në rastet kur gabimi ka ndodhur përpara periudhës më të hershme të paraqitur.*

Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin. Gabimet jomateriale duhet të korigjohen në periudhën kontabël aktuale. Korigjimi i gabimeve jomateriale në retrospektivë nuk lejohet.

5. Ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese

5.1. Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit që ndikojnë në pasqyrat financiare të vitit

Nuk ka asnjë ngjarje të ndodhur pas mbylljes së periudhës raportuese, që evidenton kushte se kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese, por para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, që kërkojnë rregullim të shumave të njohura në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për të pasqyruar ngjarjet rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese, nëse ato janë materiale.

5.2. Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit, për të cilat nuk bëhen rregullime, pasi nuk ndikojnë në pasqyrat financiare të vitit, por në periudhën në vijim, me ndikim material në aktivitetin tregtar të shoqërisë.

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje materiale pas datës së bilancit që të evidentojë kushte që kanë ekzistuar pas mbylljes së periudhës raportuese që të përshkruhet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Njësia ekonomike nuk do të korigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarjet për të cilat nuk bëhen rregullime, pas përfundimit të periudhës raportuese. Efekti i ngjarjeve për të cilat nuk bëhen rregullime do të përshkruhet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nëse ato janë materiale.

6. Shpjegime mbi palët e lidhura

Shoqëria nuk ka investuar në palët e treta dhe palët e treta nuk kanë interesa në shoqëri. Transaksionet e bëra me ortakët si palë e lidhur apo familjarët e tyre nuk janë të lidhura me aktivitetin tregtar (afarizmin) të shoqërisë.

Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenca e kontrollit, kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetrën.

7. Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Politikat e menaxhimit të rrezikut të shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përballen shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdon)

(i) Rreziku i kredisë

Rreziku i mos - pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arkëtueshme. Maksimumi i rrezikut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve.

(ii) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktiviteti i saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria administron rrezikun kryesisht përmes mbështetjes së financimit afatshkurtër dhe afatgjatë.

(iii) Rreziku i tregut

Rreziku i normave të interesit

Ekspozimi kryesor i shoqërisë ndaj rrezikut të normave të interesit lidhet me huatë që mbartin interes. Drejtuesit nuk kanë hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky risk.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ekspozohet ndaj Rrezikut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me huatë në USD, EUR. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 Dhjetor.

Informacion në zbatim të nenit 16 të Ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM dhe të VKM Nr. 17, datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private të rëndësishme për interesin e publikut për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre.”

Shoqëria nuk është NIP

8. Analiza e posteve të pasqyrës së pozicionit financiar (bilancit)

8.1. Aktivet afatshkurtra

8.1.1. Mjete monetare

Gjëndja e MM për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Banka	1,055,940	146,087
Arka	12,769,467	1,591,200
Totali	13,825,407	1,737,287

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9.1.1.1. Gjëndjet e aktiveve monetare

Llogaria	LEK	\$USD	LEK	€EURO	LEKE	Totali / LEK
Raiffeisen	291,318	-	-	110.41	10,837	302,155
Tirana Bank	3,632	-	-	-	-	3,632
BKT	1,477	-	-	41.58	4,081	5,558
ISP	8,767	-	-	7,471.54	733,332	742,099
Credins		7.38	696	-	-	696
Union Bank	1,800	-	-	-	-	1,800
Total 2024	306,994	7.38	696	7,623.53	748,250	1,055,940
Total 2023	52,460	486.18	45,672	461.64	47,955	146,087

8.1.2. Të drejta të arkëtueshme

Gjëndja e të drejtave të arkëtueshme për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga klientët – aktiviteti shfrytëzimit	26,851,616	23,764,797
Paradhënie për t'u arkëtuar	3,475,255	19,052,420
Tatim mbi fitimin	-	543,628
TVSH	-	3,576,506
Shteti- pagesa doganore paradhënie	96,525	354,545
Debitorë të tjerë	757,915	-
Totali i kërkesave tjera nga aktiviteti	4,329,695	23,527,099
Totali	31,181,311	47,291,896

8.1.3. Inventarët

Gjëndja inventarëve për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Materiale të para	31,353,682	17,470,505
Materiale ndihmëse	28,117,442	47,318,606
Total materiale	59,471,124	64,789,111
Produkte të gatshme	117,551,802	144,913,365
Mallra	88,500,782	57,050,267
Mallra - AAM për shitje	953,040	953,040
Totali	207,005,624	202,916,672
	266,476,748	267,705,783

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.2. Aktive afatgjata

8.2.1. Aktive afatgjata materiale

Gjëndja e aktiveve afatgjata materiale për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Toka e troje	167,324,470	165,696,970
Ndërtesa	61,940,724	62,352,341
Kapanon-repart prodhimi	15,190,838	15,990,354
Panele diellore	47,097,394	40,550,483
Totali toka e ndërtesa	291,553,426	284,590,148
Makineri dhe paisje	11,936,137	13,129,592
Linja prodhimi	66,634,071	74,037,859
Totali makineri	78,570,208	87,167,451
Mjete Transporti	37,959,043	43,581,998
Mobilje e orendi	5,269,439	4,774,667
Kompjuterë e paisje informatike	99,450	111,124
Totali të tjera instalime e pajisje	43,327,932	48,467,789
AAM në proces	1,911,598	
Totali AAM	415,363,164	420,225,388

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9.2.1.1. Gjëndja dhe lëvizja e aktiveve AAM dhe amortizimit

Përshkrimi	Toka, troje	Ndërtesa	Ndërtime speciale	Panele diellore	Inst. Mak. e paisje të leviz.	Inst. Mak. e paisje (linja)	Mjete transporti	Mobilje e paisje zyre	Paisje inform. e kompj.	AAM në proces	Totali
Kosto											
Në 1 Janar 2024	165,696,970	70,659,284	22,491,094	42,684,719	45,043,531	234,182,315	59,258,078	13,065,471	440,372	-	653,521,834
Shtesa- blerje/ndërtime	1,627,500	-	-	8,986,307	-	-	-	997,800	-	1,911,598	13,523,598
Paksimet (shitje, JP)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Balanca 31.12.2024	167,324,470	70,659,284	22,491,094	51,671,026	45,043,531	234,182,315	59,258,078	14,063,271	440,372	1,911,598	667,045,039
Amortizimi											
Në 1 Janar 2024	-	8,306,943	6,500,740	2,134,236	31,913,939	160,144,456	15,676,080	8,290,804	329,248	-	233,296,446
Llogaritur për vitin	-	411,617	799,516	2,439,396	1,193,455	7,403,788	5,622,955	503,111	11,591	-	18,385,429
Amortizimi i AAM të dala	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bilanci 31.12.2024	-	8,718,560	7,300,256	4,573,632	33,107,394	167,548,244	21,299,035	8,793,832	340,922	-	251,681,875
Vlera neto e librit											
Ne 31 Dhjetor 2024	167,324,470	61,940,724	15,190,838	47,097,394	11,936,137	66,634,071	37,959,043	5,269,439	99,450	1,911,598	415,363,164
Ne 31 Dhjetor 2023	165,696,970	62,352,341	15,990,354	40,550,483	13,129,592	74,037,859	43,581,998	4,774,667	111,124	-	420,225,388

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.2.2. Aktive tatimore të shtyra

Shoqëria nuk ka gjëndje të aktivitetit tatimor të shtyrë për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor.

8.3. Detyrime afatshkurtra

8.3.1. Titujt e huamarrjes

Gjëndja e huamarrjeve afatshkurtra bankare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Tepërcat kreditore të llogarive likuiduese (OD)	19,134,000	20,257,604
Hua bankare (Credins-overdraft me kontratë)	46,065,697	59,375,891
Hua bankare (Tirana Bank-overdraft me kontratë)	38,271,077	46,739,206
Totali OD	103,470,774	126,372,701
Pjesa huave AGJ që mbartin interesa që do të paguhet brenda 12 muajve të ardhshëm – Credins Nr. 96304	8,943,219	17,035,498
Pjesa huave AGJ që mbartin interesa që do të paguhet brenda 12 muajve të ardhshëm Nr. 470501	974,298	1,017,839
Pjesa huave AGJ që mbartin interesa që do të paguhet brenda 12 muajve të ardhshëm Nr. 470001	5,909,633	6,173,790
Pjesa huave AGJ që mbartin interesa që do të paguhet brenda 12 muajve të ardhshëm Nr. 470001	-	1,805,022
Totali Kredi AGJ (pjesa ASH)	15,827,150	26,032,149
Totali hua bankare ASH	119,297,924	152,404,850

8.3.2. Të ardhura të shtyra

Në pozicionin “të ardhura të shtyra” gjithsej 151,034,315 (2023: 92,680,370) LEKË, janë pasqyruar të ardhurat e parealizuar nga faturat e prera për paradhëniet 2024. Paradhëniet e faturuara nuk klasifikohen furnizim malli sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 dhe nenit 11, të UMF Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për TVSH...”.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.3.3. Detyrime afatshkurtra tregtare

Gjëndja e detyrimeve afatshkurtra tregtare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj furnitorëve	56,596,192	57,545,997
Pagat e punonjësve	1,592,279	-
Sigurime shoqërore e shëndetësore	1,186,358	994,686
Totali detyrime sociale	2,778,637	994,686
TAP	150,670	43,160
Tatim fitimi	1,170,103	-
TVSH	691,882	-
Tatim në burim	7,140	7,140
Total detyrime tatimore	2,019,795	50,300
Detyrim e tjera	-	815,520
Hua nga palët e treta që nuk mbartin interesa	-	35,028,085
Totali – të tjera të pagueshme	-	35,843,605

8.4. Detyrime afatgjata

8.4.1. Titujt e huamarrjes

Gjëndja e huamarrjeve afatgjata bankare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
ISP - Hua bankare AGJ Nr. 470001	16,772,321	23,670,383
ISP - Hua bankare AGJ Nr. 470501	2,765,156	3,902,419
Credins - Hua bankare AGJ Nr. 96304	-	8,940,894
Totali¹	19,537,477	36,513,696

8.4.2. Detyrime të pagueshm afatgjata

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Ortakë - kontribute	52,873,978	52,873,978
Ortakë - kontribute (rivlerësim troje)	147,746,070	147,746,070
Totali	200,620,048	200,620,048

¹ Është hua bankare AGJ (pjesa e kërkueshme pas datës 31.12.2024)

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.5.Kapitali dhe rezervat

Gjëndja e kapitalit dhe rezervave për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Kapital i nënshkruar i paguar	19,580,000	19,580,000
Rezerva ligjore	338,000	338,000
Rezerva të tjera	140,388,802	132,694,153
Fitim/(humbja) e pashpërndarë	-	-
Fitim/(humbja) e vitit	14,655,440	7,694,649
Totali	174,962,242	160,306,802

Shënime për pasqyrat financiare

për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

8.5.1. Gjendja dhe ndryshimi i kapitalit

Struktura	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e pashpërnd.	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 01 Janar 2023	19,580,000	338,000	121,644,896	-	11,049,257	152,612,153
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitim/(humbja) e vitit	-	-	-	-	7,694,649	7,694,649
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	7,694,649	7,694,649
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Emetim i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-
Përdorimi i fitimit të pashpërndarë	-	-	11,049,257	-	(11,049,257)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	11,049,257	-	(11,049,257)	-
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2023	19,580,000	338,000	132,694,153	-	7,694,649	160,306,802
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin						
Fitim/(humbja) e vitit	-	-	-	-	14,655,440	14,655,440
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	14,655,440	14,655,440
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Emetim i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-
Përdorimi i fitimit të pashpërndarë	-	-	7,694,649	-	(7,694,649)	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	7,694,649	-	(7,694,649)	-
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2024	19,580,000	338,000	140,388,802	-	14,655,440	174,962,242

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9. Pasqyra performancës (PASH)

Paraqitja e PASH është bërë duke i klasifikuar sipas natyrës

9.1. Të ardhurat

9.1.1. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga shitja e prodhimit (M. Laster)	141,917,375	94,377,035
Të ardhura nga shitja e mallit	73,023,263	33,170,380
Të ardhura nga shitja e L. I-rë	11,874,486	13,924,005
Të ardhura nga shërbime	27,640,495	2,180,048
N/totali të ardhura nga aktiviteti kryesor	254,455,619	143,651,468
Të ardhura nga shitja e AAM	-	28,150,926
Të ardhura nga qira	930,258	45,000
Të ardhura tjera – Transport P3	169,405	-
N/total	1,099,663	28,195,926
Të ardhura nga rimbursim dëmi	-	1,328,434
Total	255,555,282	173,175,828

9.1.2. Ndryshime në inventarin e produkteve të gatëshme dhe PP (+/-)

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Ndryshime në inventarin e produkteve të gatëshme dhe PP (+/-) (mermer lastër)	(27,361,563)	22,677,173
Totali	(27,361,563)	22,677,173

9.2. Shpenzimet

9.2.1. Shpenzime për mallra, lëndë e parë dhe materiale të konsumuara

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Blerje/Shpenzime të materialeve të para	18,767,357	41,658,185
Blerje/Shpenzime të materialeve ndihmese	32,919,452	20,248,620
Blerje/shpenzime mallrash	40,570,551	14,217,139
Totali	92,257,360	76,123,944
Blerje/shpenzime mallrash - ujë e energji	3,933,982	5,038,023
Totali	96,191,342	81,161,967

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9.2.2. Të tjera shpenzime shërbimi të shfrytëzimit

Shpenzimet për aktivitetin e shfrytëzimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime për qira	1,346,880	1,171,200
Shpenzime për riparime	22,175,414	1,721,132
Shpenzime për udhëtime e dieta	245,600	-
Shpenzime për prime sigurimi	1,210,289	1,492,752
Shpenzime për karburant - Transport	4,602,638	8,333,924
Shpenzime për transport - shitjet	-	357,331
Shpenzime për personel nga jashtë	393,835	434,850
Shpenzime përfaqësimi e reklama	-	14,708
Shpenzime për telekomunikacion	786,606	937,501
Shpenzime për shërbime bankare	1,743,079	1,442,437
Shpenzime për tatime e taksa e tarifa regjistrimi	951,777	1,700,534
Shpenzime të tjera – blerje të pastokueshme	220,815	-
Shpenzime të tjera	-	1,150,000
Shpenzime të tjera - doganore etj	462,474	1,995,589
Totali	34,139,407	20,751,958

9.2.3. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Pagat e personelit	45,604,346	41,130,323
Shpenzimet për sigurime shoq. e shëndet	7,774,773	6,694,390
Totali	53,379,119	47,824,713

9.2.4. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Amortizimi i AAM	18,385,429	14,919,301
Kosto e aktiveve afatgjata materiale (AAM) të dala	-	21,815,211

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin fiskal që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023
(Të gjitha balancat janë në LEK)

9.2.5. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Në shpenzimeve të tjera të shfrytëzimit janë pasqyruar shpenzimet e pazbritëshme, gjithsej 2,709,298 (2023: 140,400) Lekë.

9.2.6. Shpenzime financiare

Rezultati financiar për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Llogaria	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime neto nga interesat bankare	(10,642,352)	(15,297,482)
Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit	4,973,033	15,135,336
Totali	(5,669,319)	(162,146)

10. Rezultati tatimor

Gjëndja e mjeteve monetare për periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

Rezultati tatimor	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitim/(humbja) para tatimit	17,719,805	9,077,305
Shpenzime të pazbritëshme:	2,709,298	140,400
<i>Gjoka e penalitete</i>	37,202	9,021
<i>Të tjera</i>	2,672,006	131,379
Fitimi/(humbja) tatimor/e	20,429,103	9,217,705
Humbje tatimore e mbartur	-	-
Fitimi i tatueshem	20,429,103	9,217,705
Tatim/ fitimin	3,064,365	1,382,656
Fitim/(humbja) pas tatimit	14,655,440	7,694,649

Data 13.03.2025



Vladimir VELO
Financier



Agim XHINDOLI
Administrator

